



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2659/ 1 prot.,

Datë 27.08.2026

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TRONIX” ShPK në procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*” Mallra, me Nr. REF-95090-07-31-2026, me objekt “Blerje lubrifikantësh për nevojat e Bashkisë Divjakë”, me fond limit: 5,407,560 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.08.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Divjakë.

Ankimues: Operatori ekonomik “TRONIX” ShPK, me Nipt L71821024L.
Adresa: Vaqarr, Zona Kadestrale 3712 Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Divjakë.
Adresa: Lagjja nr.2, Sheshi “Santa Barbara”, Divjakë.

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/7204, datë 26.08.2026 dhe me Nr. 2659/2026 Prot., date 26.08.2026 e operatorit ekonomik “TRONIX” ShPK, për procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*” Mallra, me Nr. REF-95090-07-31-2026, me objekt “Blerje lubrifikantësh për nevojat e Bashkisë Divjakë”, me fond limit: 5,407,560 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.08.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Divjakë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “TRONIX” ShPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 3, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon: **b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;**”

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsye e skualifikimit:

Operatori Ekonomik TRONIX SHA, me NIPT L71821024L, nuk plotëson Kriterin 2.3.3 i cili kërkon që, “Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Raport analiza të leshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) ose dhe Laborator i Akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar të Akreditimit për produktet si më poshtë: Vaj motori 15W-40, Vaj motorri 20W-50 ; Vaj reduktori 80W-90; Vaj Hidrauliku ISO VG 46; Vaj Hidrauliku ISO 68; Graso EP -2 Lithium, Graso Kalcium, Vaj Motorri 10W-40 ku vlerat e raportit Analizave të jenë brenda kufijve të vlerave të kërkuara në shtojcën 6 Specifikime Teknike të DST të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Divjakë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, u konstatua se:

-Për produktin “Vaj motorri 20W-50”, treguesi i kërkuar nga dokumentat Standarte të Tenderit për: Viskoziteti kinematik me 40 °C, kërkohet në limitin (125 ÷ 180) mm²/s.

Rezultati i analizës është 188.8 mm²/s.

Indeksi i viskozitetit, kërkohet në limitin (128 ÷ 155). Rezultati i analizës është 122.

Për produktin “Vaj motorri 10W-40”, treguesi i kërkuar nga dokumentat Standarte të Tenderit për: Viskoziteti kinematik në 40 °C, kërkohet në limitin (85 ÷ 95) mm²/s. Rezultati i analizës është 95.01 mm²/s.

Për produktin “Vaj Hidrauliku ISO VG 46”, dhe për produktin “Vaj Hidrauliku ISO 68”, të kërkuar në specifikimet teknike sipas Dokumentave Standarte të Tenderit, Operatori Ekonomik ka paraqitur 1(një) fletë analize të ISHTI, me përshkrimin “Vaj Hidrauliku”, pa përcaktuar llojin e tij si më sipër kërkuar.

Për produktin “Graso EP2, Lithium”, dhe për produktin “Graso Kalcium” Operatori Ekonomik pjesëmarrës ka paraqitur 1(një) fletë analize të ISHTI, me përshkrimin “Graso”, pa përcaktuar llojin e saj si më sipër kërkuar.

Bashkëlidhur dokumentit të Raportit Analizave të produkteve, Operatori Ekonomik ka paraqitur Raport Analiza të prodhuesit “JV YUKOIL LLC”. Nga shqyrtimi i Dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik “TRONIX SHA”, si dhe nga një konfirmim me e-mail, nga Drejtoria e Përgjithëshme e Akreditimit, Tiranë, u vërejt se:

a. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur në SPE dokumenta provuese që të vërtetojnë se subjekti “JV YUKOIL LLC” përfaqëson një “Laborator të Akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar të Akreditimit”.

b. Specifikimet e Emërtimeve të produkteve të paraqitura në Raportin Analizat e kryera nga prodhuesi “JV YUKOIL LLC” nuk përputhen me ato të kërkuara në Dokumentat Standarte të Tenderit.

c. Parametrat specifike për secilin produkt të paraqitura në Raportin Analizat e kryera nga prodhuesi “JV YUKOIL LLC” nuk përputhen me parametrat e kërkuara në DST, ose në disa raste mungojnë tërësisht. Specifikisht në raportin analiza mungojnë parametrat si “Viskoziteti kinematik në 100 °C” dhe “Densiteti në 15 °C”.

Në lidhje me plotësimin e kriterit 2.3.5 i cili kërkon që “Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë katalog ose broshura ose etiketa të zërave për produktet si më poshtë:

Vaj Motori 15W-40, Vaj Motorri 20W-50; Vaj Motorri 10W-30, Vaj Reduktori 80W-90; Vaj Hidrauliku ISO VG 46; Vaj Hidrauliku ISO 68; Vaj Motorri 10W-40 Vaj Motorri 10W-40 për kamiona, Vaj kambio ATF, Vaj transmisioni 75W-90, Graso EP -2 Lithium, Graso me bazë

Calcium, Adblue, Antifreeze, Alkol Frenash, Vaj Transmisioni TDTO 30, Vaj Transmisioni TDTO 50, Vaj Transmisioni MTO, Vaj motorri 2T, Vaj motorri 4T, Vaj Hidrauliku 10W, Vaj transmisioni 10W-30, nga furnitori i tij dhe nëse është prodhues të sjellë katalogun ose broshurat ose etiketat e tij, ku të jepen treguesit e vlerave teknike, nëse i plotesojne kushtet e kërkuara dhe specifikimet teknike të produkteve në katalog ose broshurat ose etiketat të cilat duhet të përputhen me specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Divjakë. (Katalogjet ose broshurat ose etiketat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar)”.

Nga verifikimi i katalogut të prodhuesit “JV YUKOIL LLC” të paraqitur nga Operatori Ekonomik “TRONIX SHA”, u konstatuan mospërputhjet e mëposhtëme:

- 1. Specifikimet e Emërtimeve të produkteve të paraqitura në katalogun e subjektit “JV YUKOIL LLC” nuk përputhen me ato të kërkuara në Dokumentat Standarte të Tenderit.*
- 2. Parametrat specifikë për secilin produkt të paraqitura në katalogun e Subjektit “JV YUKOIL LLC” nuk përputhen me parametrat e kërkuara në DST, ose në disa raste mungojnë tërësisht. Specifikisht në Kataloge mungojnë parametrat si “Viskoziteti kinematic në 40 °C” dhe “Densiteti në 15 °C”. Operatori Ekonomik ka paraqitur katalogun në të cilin densiteti është në temperaturën 20 °C për të gjitha produktet.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 27.08.2026

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Kryetar
Ismail Shehu